



QENDRA
KINEMATOGRAFIKE
E KOSOVËS

Qendra Kinematografike e Kosovës, në bazë të nenit 14 të Ligjit Nr. 08/L-202 për Kinematografinë dhe Rregullores (MKRS) Nr. 02/2023 për konkurset dhe mbështetjen financiare të veprave filmike dhe audio-vizuale shpall:

**KONKURS PËR ZHVILLIM TE PROJEKTIT, PËR FILM TË
METRAZHIT TË GJATË (ARTISTIK, DOKUMENTAR DHE TË
ANIMUAR) - (mbi 60 minuta)**

Ref. Nr. QKK 11/2026

Të drejtë konkurimi kanë të gjithë personat juridik, vendas ose të huaj, të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit dhe paraprakisht të regjistruar në QKK dhe që i plotësojnë kushtet e kërkuara me këtë konkurs.

I. APLIKIMI

Aplikimi bëhet përmes emailit: konkurset.qkk@rks-gov.net

- Në subjektin (Subject) të emailit duhet të shënohet kategoria e aplikimit me numër të referencës dhe emri i projektit, sipas shembullit më poshtë:

Ref. Nr. QKK 11/2026 - Emri i Projektit

Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të bashkëngjiten si **PDF Files veç e veç në email**, sipas renditjes në paragrafin **II**.

Madhësia totale e të gjitha dokumenteve të bashkëngjitura nuk duhet të tejkalojë 20 MB.

Sqarim:

Në rast se aplikuesi dërgon më shumë se një aplikim për të njëjtin projekt në të njëjtën kategori, vetëm aplikimi i dërguar përmes emailit të parë do të merret parasysh. Brenda 48 orëve, aplikuesi do të pranojë konfirmimin për pranimin e aplikimit.

Aplikimet me dokumentacion të pakompletuar diskualifikohen, në përputhje me Rregulloren (MKRS) Nr. 02/2023¹ për Konkurset dhe Mbështetjen Financiare të Veprave Filmike dhe Audio-vizuale, Neni 12, pika 1.

Tarifa e aplikimit:

Aplikimi për Konkursin për Zhvillim të Projektit për Film të Metrazhit të Gjatë Artistik, Dokumentarë dhe të Animuar kushton 50€ (pesëdhjetë euro).

Mënyra e pagesës së aplikimit:

Fletëpagesa merret në zyret e QKK-së dhe duhet të dorëzohet fizikisht së bashku me konfirmim të pagesës në zyret e QKK-së.

II. DOKUMENTET E KËRKUARA

1. Forma e Aplikimit, së bashku me testin e kulturës (të shkarkohet nga Website i QKK);
2. Siposis;
3. Tritment;
4. Biografi dhe filmografinë e anëtarëve kryesorë të ekipit (regjisorit, producentit, skenaristit, etj.);
5. Linqet e filmave të mëhershëm të regjisorit dhe producentit.
 - Për regjisorin:
 - Dy filma të metrazhit të shkurtër; ose
 - Një film të metrazhit të gjatë.
 - Për producentin:
 - Dy filma të metrazhit të shkurtër; ose
 - Një film të metrazhit të gjatë.
 - Pranohet vetëm:
 - i. Vimeo me password, valid deri në ditën e shpalljes së rezultateve; ose
 - ii. YouTube Unlisted, me link të klikueshëm dhe të integruar (embedded).
6. Skenar (të plotë);
7. Buxheti i kërkuar nga QKK (të shkarkohet nga Website i QKK);
8. Buxheti i detajuar i projektit, përfshirë fondet e tjera;
9. Deklarata e producentit/shtëpisë filmike për të drejtat autoriale të skenarit ose kontrata ndërmjet producentit dhe skenaristit, ku qartësohen të drejtat autoriale;
10. Vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), që dëshmon se aplikuesi nuk ka obligime tatimore të pashlyera.
11. Dokumente të tjera relevante që mund t'i ndihmojnë aplikimit.

Kujdes: Të gjitha dokumentet duhet të bashkëngjiten veç e veç dhe **madhësia totale e dokumenteve të bashkëngjitura nuk duhet të tejkalojë 20 MB.**

III. KUFIZIMET NË PJESËMARRJE

1. Shtëpitë filmike që janë me vonesë në zbatimin e kontratave paraprake nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
2. Shtëpitë filmike nuk kanë të drejtë konkurimi me më shumë se tri projekte brenda konkursit.
3. Projektet që kanë filluar me xhirime nuk mund të aplikojnë në këtë kategori.
4. Projektet që janë refuzuar tre herë në thirrjet e mëparshme nuk kanë të drejtë aplikimi.

Vërejtje - referuar Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit: punëtorët e Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit, dhe institucioneve vartëse të saj, nuk kanë të drejtë aplikimi në Konkurs.

Konkursi është i hapur nga data 23.09.2026 deri më 25.10.2026, në orën 00:00.